



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 3
Prishtinë, më 30.10.2017, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Aida Dërguti, Visar Ymeri, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Evgjëni Thaçi-Drăgusha, Sergjan Mitroviç dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Doruntinë Maloku-Kastrati.

Në mbledhje ishte prezent për raportim, ministri i MPJ-së, z. Behgjet Pacolli, me bashkëpunëtorët: Florent Muçaj, Mentor Nezalo, Jetlir Zyberaj, Muhamet Brajshori dhe Albert Prenaj.

Nga pjesëmarrësit tjerë: Artan Murati, Jeta Krasniqi, Violeta Haxholli, Egzon Osmanaj, KDI; Vlora Nushi, OPA-UNMIK; Egnesa Vitia, praktikante; Gurjeta Zeka, LVV dhe media.

Nga zyra e komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24 tetor 2017;
3. Prezantim i hulumtimit parlamentar i përgatitur nga KDI;
4. Shqyrtimi i propozimeve për formimin e grupeve të miqësisë;
5. Raportim i ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Behgjet Pacolli;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24 tetor 2017

Kryetarja konstatoi se komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 24 tetor 2017.

3. Prezantim i hulumtimit parlamentar i përgatitur nga KDI

Vjosa Osmani, njoftoi se hulumtimi parlamentar për rregullimin e lëshimit të fletë arresteve sipas së drejtës ndërkombëtare, është kërkuar nga komisioni në legjislaturën e kaluar. Bashkëpunimi me KDI-në, tha se do të vazhdojë. Në vazhden e aktiviteteve të komisionit, do të kemi edhe hulumtime të tjera. Ajo ftoi përfaqësuesit e KDI-së, që të prezantojnë hulumtimin në fjalë.

Jeta Krasniqi, nga KDI, tha se bazuar në Memorandumin e mirëkuptimit në mes të Kuvendit dhe KDI-së, kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë me komisionin. Ky bashkëpunim, ka për qëllim që të përforcojë rolin e Kuvendit në mbikëqyrjen e dialogut Kosovë-Serbi dhe të rrisë rolin e pjesëmarrjes së qytetarëve në dialog. Ajo njoftoi edhe për bashkëpunimin dhe aktivitetet e realizuara, gjatë legjislaturës së kaluar.

Artan Murati, lidhur me hulumtimin për rregullimin e lëshimit të fletëarresteve, sipas së drejtës ndërkombëtare, të realizuar me kërkesë të komisionit, tha se është angazhuar prof. Qerim Qerimi, në të cilin punim mund të shihet mënyra e rregullimit të lëshimit të fletëarresteve, sipas së drejtës ndërkombëtare. Si e gjetur e parë nga ky hulumtim del fakti se nuk ka ndonjë traktat të unifikuar, në bazë të të cilit rregullohet çështja e lëshimit të fletëarresteve dhe e ekstradimit. Kjo çështje, kryesisht vendoset në bazë të legjislacionit të brendshëm të shteteve të cilat i lëshojnë fletëarrestet, bazuar në marrëveshjet dypalëshe në mes shteteve. Korniza e rregulluar në këtë fushë, vjen nga INTERPOL-i, përmes mekanizmit të saj “red notice”, që nuk është urdhër i menjëhershëm për t’u arrestuar dikush, nga personat e shpallur në kërkim, por u mbetet shteteve që ta vlerësojnë se a do ta zbatojnë apo jo. Më pas, njoftoi edhe për dy mekanizma të tjerë që e rregullojnë këtë çështje në nivel evropian. Z. Murati ceku se shteti serb ka dy ligje përmes të cilave ka gjetur bazë ligjore për përfshirjen në fletëarreste të shtetasve të Republikës së Kosovës, sipas ligjit për organizimin dhe kompetencën e anëtarëve qeveritarë në procedurën e krimeve të luftës dhe ligjit për ndihmë reciproke për çështje penale. Ai bëri të ditur se nga hulumtimi del se është shumë e rëndësishme që shteti i Kosovës të jetë shumë më produktiv dhe të ketë diskutim të vazhdueshëm, kryesisht me shtetet, me të cilat kemi raporte diplomatike, në mënyrë që t’i paralajmërojmë për mundësinë e lëshimit të fletëarresteve nga shteti serb dhe të kërkojmë nga ato që këto të mos zbatohen.

Vjosa Osmani, theksoi se Republika e Serbisë, përveç anëtarësimit në INTERPOL, e shfrytëzon edhe mundësinë e lëshimit të fletëarresteve edhe përmes ligjit për organizimin dhe kompetencat e autoriteteve qeveritare në procedimin e krimeve të luftës, me qëllim të ngritjes së aktakuzave e fletëarresteve ndaj shtetasve të të gjitha shteteve të botës, ngase sipas tyre krimi është kryer në territorin e ish-Jugosllavisë. Pyeti përfaqësuesit e KDI-së, nëse kemi rekomandim konkret lidhur me qëndrimin që duhet të ketë Republika e Kosovës, rreth lëshimit të fletëarresteve të Serbisë, se cili do të ishte veprimi i ndërmarrë nga Kosova, që ta parandalojë Serbinë në lëshimin e fletëarresteve.

Jeta Krasniqi, njoftoi se rekomandimi i prof. Qerimit ka qenë që çështja e fletëarresteve nga ana e Serbisë të jetë pjesë e dialogut Kosovë-Serbi, në kuadër të normalizimit të marrëdhënieve dhe se këtë çështje do ta diskutojë sërish me prof. Qerimin.

Dukagjin Gorani, duke pasur parasysh se kur është kërkuar ky hulumtim, nuk është përfshirë një mision i rëndësishëm, e që është mundësia e lëshimit të fletë arresteve ndërkombëtare nga ana e Kosovës, pyeti përfaqësuesit e KDI-së, për këtë mundësi.

Artan Murati, mundësitë e Kosovës për lëshimin e fletë arresteve nga ana e Kosovës, tha se janë të kufizuara, pasi që nuk është shtet anëtar i INTERPOL-it, e as nuk ka ulëse në Këshillin e Evropës. Mundësi e vetme në këtë drejtim do të ishte marrëveshja në mes të shteteve specifike.

Visar Ymeri, duke u ndërlidhur me hulumtimin, tha se si komision duhet të jemi më kreativ, sa i përket gjetjes së mekanizmave institucionalë për të vepruar dhe në atë mënyrë të arrihet sukses më afatgjatë. Pos figurave publike, z. Ymeri theksoi se kemi pasur edhe shumë ushtarë të UÇK-së, që kanë mbajtur burg në Serbi. Trajtimin e lëshimit të fletëarresteve nga ana e Serbisë, në Bruksel, për shtetasit tanë, tha se nuk e sheh të arsyeshëm, ngase nuk do të zgjidhej atje, por MPJ, nëse nuk e ka bërë deri më tani, do të duhej të vërë kontakte shumë më të shpeshta me Kroacinë, për këtë çështje, ngase edhe Kroacia e lufton këtë juridiksion, e më pas edhe me shtete të tjera që kanë qenë pjesë e ish-Jugosllavisë.

Elmi Reçica, theksoi se ky është një ndër hulumtimet e para të kërkuara të komisionit, i cili më pas mund të plotësohet. Ai tha se kjo çështje shpreson që të mbyllet kur Kosova të jetë e integruar në INTERPOL, e po ashtu duke pasur parasysh se ky hulumtim ka të bëjë me dialogun Kosovë-Serbi çështja e fletë arresteve duhet të shtrohet në dialog. Po ashtu, z. Reçica tha se kemi mungesë të hulumtimeve të tilla dhe të dokumenteve dhe se këtë çështje duhet shtruar në rrafshin shkencor dhe ligjor dhe të kemi një qëndrim sa i përket kësaj çështjeje.

Zafir Berisha, për fenomenin e lëshimit të fletëarresteve nga Serbia, tha se nuk do të duhej të diskutohet në Bruksel, sepse të gjitha çështjet që diskutohen atje, janë përulje ndaj Serbisë. Më tej, shtoi se të gjitha diskutimet e bëra në Bruksel i konsideron nënshtrim ndaj Serbisë, ngase ajo nuk ka qenë kompetente dhe se është bërë palë e panevojshme në çështjet e Kosovës.

Time Kadrijaj, duke u mbështetur në diskutimet, tha se varet nga secili shtet se a do t'i respektojë lëshimet e fletë arresteve. Pra, është detyrë e secilit prej nesh që të kërkojmë nga vendet e BE-së, që të mos i njohin fletë arrestet e Serbisë.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

Përfundim

Të kërkohej nga Qeveria e Kosovës, që të dërgojë zyrtarisht gjithë dokumentacionin lidhur me dialogun Kosovë-Serbi, si vijon:

- *marrëveshjet e arritura;*
- *aneks-marrëveshjet;*
- *konkluzionet e arritura;*
- *planet e zbatimit të marrëveshjeve dhe gjithë dokumentacionin që ka të bëjë me marrëveshjet.*

4. Shqyrtimi i propozimeve për formimin e grupeve të miqësisë

Vjosa Osmani, lidhur me formimin e grupeve të miqësisë, tha se për shumicën nga to, kemi nxjerrë propozimet, megjithatë propozimi duhet të plotësohet edhe me disa grupe të tjera të miqësisë. Pas diskutimeve nga deputetët, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

Përfundim

Të plotësohet propozimi për formimin e grupeve të miqësisë edhe me propozimet për formimin e grupeve të miqësisë me Afrikën dhe me Lindjen e Mesme.

Grupi i Miqësisë me Panamanë, të mbetet i veçantë dhe të formohet një grup i veçantë i miqësisë me Amerikën Latine e Karaibet.

Propozimi për formimin e grupeve të miqësisë me plotësimet e sipër përmendura, t'i përcillet Kryesisë së Kuvendit për miratim.

5. Raportim i ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Behgjet Pacolli

Vjosa Osmani, lidhur me bashkëpunimin në mes të komisionit dhe MPJ-së, njoftoi ministrin Pacolli se komisioni ka vendosur që të kemi një bashkëpunim më të madh dhe raportime më të shpeshta të ministrit në komision. Theksoi se kësaj radhe ministri është ftuar që të raportojë lidhur me Strategjinë e Republikës së Kosovës, në raport me Marrëveshjen për demarkacion me Malin e Zi, si dhe për çështjen e tërheqjes së Kosovës nga aplikimi për anëtarësim në INTERPOL dhe UNESCO.

Behgjet Pacolli, tha se çështja e demarkacionit është një temë e cila e rëndon më shumë politikën e brendshme të Kosovës. Marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Malit të Zi, janë të mira dhe qeveritë e dy vendeve vlerësojnë se bashkëpunimi rajonal është një faktor i rëndësishëm në politikën e tyre të jashtme, me impakt në zhvillim dhe prosperitetin e dy vendeve. Kosova e ka vlerësuar shumë lart njohjen nga Mali i Zi, një hap që kërkonte guxim të lidhshimit, pa marrë parasysh situatën në vend. Po ashtu, njoftoi se ishte në vizitë në Mal të Zi, dhe sipas tyre, demarkacioni i kufirit është një çështje e mbyllur, e nënshkruar dhe e ratifikuar në Parlamentin e tyre. Marrëveshja, sipas Malit të Zi, nuk ka asnjë mundësi që të rinegociohet. Ky demarkacion i kufirit është bërë sipas metodës së aplikuar në ish-Jugosllavi në vitin 1956, bazuar në kufijtë kadastralë të komunave. Ai tha se shpreson që Komisioni i ri i demarkacionit do të sjellë fakte të reja, që dëshmojnë se kufiri është aty ku mendon Komisioni shtetëror për demarkacion, ndërsa ne do të bëjmë çmos që të interpretojmë vullnetin dhe programin e Republikës së Kosovës, në interes të ruajtjes së çdo centimetri të saj.

Sa i përket aplikimit për anëtarësim në UNESCO, ministri tha se është dashur që më dt. 2 shtator të aplikohet, por nuk kemi aplikuar. Nuk kemi pasur siguri se do të kalojmë pa pengesa, si dhe patëm vendimin nga Kryeministri që të mos aplikojmë. Ne nuk e tërhoqëm aplikimin, por këtë synim e spostuam për vitin 2019. Këtë shtyrje, tha se e mbështet, pasi që nuk kemi qenë të gatshëm dhe nuk e kemi pasur të përmbushur obligimin për miratimin e dy ligjeve në Kuvend. Sa i përket aplikimit për anëtarësim në INTERPOL, tha se nuk ka pasur tërheqje nga aplikimi, por aplikimin e kemi shtyrë për në samitin e radhës, që do të mbahet në Abu Dhabi. Ai shtoi se nuk kemi qenë larg synimit për aplikim sikur të kishim edhe 2-3 ditë, por për shkak të pamundësisë së prezencës tonë atje, në mungesë të vizave dhe mosnjohjes së kushteve që i nënshtrohet Kosova atje, është spostuar ky aplikim.

Vjosa Osmani, lidhur me raportimin për çështjen e demarkacionit, pyeti ministrin: cili do të ishte rekomandimi i tij për Kryeministrin, ta sjellë këtë marrëveshje në Kuvend për ratifikim apo do t'i rekomandonit që të tentojë pafundësisht ta bindë Malin e Zi, që marrëveshja të rinegociohet apo të shkojnë në arbitrazh? Sa i përket mos aplikimit për anëtarësim në UNESCO, pyeti: pse nuk është arritur që dështimet e aplikimit të parë të mbulohen gjatë këtyre dy viteve të përpjekjes së dytë? Çështja e anëtarësimit në INTERPOL, tha se nuk është vetëm çështje e anëtarësimit në një organizatë ndërkombëtare, por është edhe çështje e sundimit të ligjit. Po ashtu, pyeti ministrin: a pajtohet me deklaratimet e Presidentit se miqtë tanë na kanë prerë në besë dhe përderisa Palestina po arrin të anëtarësohet në këto organizata, premtimet që i janë dhënë për Kosovën nuk po mbahen, apo ky është një mos lexim i saktë i situatës?

Behgjet Pacolli, sa i përket kohës kur është dashur të aplikohet për anëtarësim në UNESCO, më dt. 2 shtator, tha se në atë kohë kemi qenë në vakum institucional dhe shumë pak jemi marrë me punët e përditshme. Lidhur me demarkacionin, tha se është formuar Komisioni i ri shtetëror dhe shpreson se do të sjellë fakte të arsyeshme për të kërkuar rinegocim të marrëveshjes. Sa i përket çështjes së INTERPOL-it, mes tjerash, tha se do të ftojë anëtarët e komisionit, që të jenë pjesë e task-forcës së formuar.

Visar Ymeri, theksoi se kanë njoftimin se tani policia e Malit të Zi po e kontrollon atë pjesë të Kosovës, që është në kontestim e sipër, e që nuk ka të drejtë, dhe se shteti i Kosovës nuk ka reaguar

fare, gjë që do të duhej ta bënte sa më shpejt. Pyeti: cili është qëndrimi i Qeverisë së Kosovës karshi demarkacionit dhe cili është mandati i Komisionit të ri shtetëror dhe çka pritet prej këtij komisioni, çka do të ndodhë me të dhënat shtesë, sa i përket vijës kufitare? Cili është qëndrimi i Qeverisë karshi komisionit të kaluar?

Lidhur me deklaratën se është kusht i padrejtë ndaj Kosovës, vënia e kushtit të demarkacionit të kufirit, pyeti: a ka ndonjë lëvizje në politikën e jashtme të Qeverisë së Kosovës për këtë padrejtësi? Duke u ndërlidhur me kushtin për miratimin e ligjeve për aplikimin për anëtarësim në UNESCO, pyeti: a do të trajtohet trashëgimia kulturore e Kosovës, si e Kosovës, apo do t'i jepet e drejta Serbisë se Kosova nuk duhet të anëtarësohet në UNESCO, meqë trashëgimia e vetme që njihet në Kosovë qenka e kishës ortodokse serbe? Ai, po ashtu, kërkoi të informohet lidhur me strategjinë dhe planin e Republikës së Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe se çka po ndërmerret për luftimin e korrupsionit, si kusht për liberalizimin e vizave.

Zafir Berisha, lidhur me njoftimin nga ministri Pacolli, për qëndrimin e Malit të Zi, pyeti: a kanë mundur ta bindin Malin e Zi se kjo marrëveshje nuk është çështje e mbyllur, pasi nuk është miratuar ende nga Kuvendi i Kosovës? Sa i përket mos aplikimit në UNESCO, tha se kjo tregon se institucionet e Kosovës nuk janë në rrugëtimin e duhur. Po ashtu, theksoi se e di se ka pasur pengesa, bllokada politike e kriza, por tani edhe ato dyer që i kemi pasur të hapura, janë mbyllur për shkak të papërgjegjësisë së diplomacisë së jashtme, për ta prezantuar interesin e Kosovës, për t'u anëtarësuar në organizata ndërkombëtare. Pyeti ministrin: si e ndien veten, si pjesë e një qeverie, pjesë e së cilës është edhe LS, e cila në legjislaturën e kaluar nuk e ka përkrahur ligjin për liritë fetare dhe si ndihet karshi vendeve që tentojmë t'i kemi miq, pasi që si anëtarë i Qeverisë e ka paditur shtetin e Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare, në një kontest privat?

Time Kadrijaj, ndër të tjera, tha se do të ishte mirë që Qeveria të jetë transparente, të njoftohemi për të gjitha zhvillimet në Kosovë dhe të kemi konsensus nacional për të gjitha vendimet. Përkrah mendimin e z. Berishës se marrëveshja për demarkacion, pa u miratuar në Kuvendin e Kosovës, nuk mund të konsiderohet çështje e kryer. Me formimin e komisionit të ri shtetëror, tha se do të njoftohemi lidhur me situatën për demarkacion. Ajo pyeti ministrin: për ç'arsye, shumë shtete që e kanë njohur Kosovën, nuk e patën votën pro anëtarësimit të Kosovës në UNESCO dhe cilat janë organizatat, në të cilat Qeveria synon të anëtarësohet në vijim?

Elmi Reçica, e përgëzoi ministrin dhe stafin e tij për këtë paraqitje të parë para komisionit dhe theksoi se përkundër angazhimeve të vazhdueshme, situatave që do të krijohen, do ta kenë mbështetjen e komisionit dhe do të koordinohen së bashku. Pas këtij takimi, lidhur me këto dy çështje që u diskutuan, z. Reçica bëri me dije se sërisht komisioni do të ketë takime me ministrin, Pacolli, që të njoftohen më gjerësisht për angazhimet dhe planet e punës dhe strategjinë, si bartës i punëve të jashtme. Ai theksoi se është shumë me rëndësi që Komisioni për demarkacion ta përmbyllë punën sa më shpejt dhe të na sjellin raportin me argumente, duke shtuar se nuk ka vullnet askush që të heqë dorë, nga diçka që është në interes të vendit.

Behgjet Pacolli, duke u ndërlidhur me çështjet e ngritura nga deputetët, fillimisht tha se detyrë e tij është që të mbrojë interesin e shtetit dhe të institucioneve të tij. Sa i përket demarkacionit, tha se nuk ka asnjë informatë nga ndonjë institucion se Mali i Zi, e kontrollon atë pjesë të territorit, që po kontestohet. Bëri të ditur se kemi obligim moral e material ndaj dokumentit të marrëveshjes dhe se sikur ta kishim pasur të qartë se nuk do të ratifikohej, nuk ishte dashur të nënshkruhet. Nëse do të vijnë fakte se ky demarkim i kufirit është i gabuar, tha se beson se do të ketë mbështetjen edhe të ndërkombëtarëve. Më tej, shtoi se Komisioni për demarkacion ka një përgjegjësi të madhe, duhet të sjellë fakte se cila është situata për demarkacionin. Sa i përket miratimit të ligjeve, ministri tha se duhet t'i përmbahemi aneksit nr. 5 të Pakos së Ahtisaarit, ku flitet për kishat ortodokse serbe në Kosovë. Lidhur me anëtarësimin në organizata të tjera ndërkombëtare, bëri të ditur se gjatë vitit të ardhshëm planifikojnë të aplikojnë edhe në organizata të tjera ndërkombëtare, si Organizatën

Ndërkombëtare të Turizmit, atë të shëndetësisë, si dhe të fëmijëve të botës. Duke u ndërlidhur me pyetjen e z. Berisha, tha se ai nuk e ka ngritur çështjen në Gjykatën Ndërkombëtare, ngase nuk është udhëheqës i grupit nga viti 2007. Grupi nuk kërkon asgjë më shumë se kthimin e mjeteve të veta. Sa i përket dialogut, tha se nuk ka ndonjë njohuri më shumë se që di Kuvendi, porse ka insistuar gjithnjë që dialogu të vazhdojë me tema, të cilat drejtpërdrejt ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe të ketë limit të caktuar kohor.

Vjosa Osmani, mes tjerash, tha se pajtohet plotësisht me ministrin, që në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga Republika e Kosovës, rrjedhin obligime të natyrës së respektit të ndërsjellë, ndërsa marrëveshja e pa ratifikuar në të dy parlamentet, nuk prodhon efekte juridike. Theksoi se do të ishte në interes të të gjithëve, që Republika e Kosovës, ta ketë një plan konkret në momentin që do ta kemi raportin nga Komisioni i ri shtetëror për demarkacion. Inkurajoi ministrin Pacolli, që në task-forcat e formuara, të përfshihet edhe Komisioni për Punë të Jashtme, që së paku një anëtar nga komisioni, të marrë pjesë në ato takime. Kërkoi nga ministri Pacolli, se nëse kanë plan të veprimit lidhur me anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, t'i përcillet komisionit me shkrim.

Mbledhja përfundoi në orën 17:15.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu